



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 22 prill 2026

Z. Përparim Rama, kryetar i komunës
Komuna e Prishtinës
Rr. "UÇK", nr. 2
10 000 Prishtinë

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 845/2025

I nderuar z. Rama,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1¹, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit², më 19 qershor 2025 pranoi ankesën e [redacted] (në vijim: [redacted]), të paraqitur kundër Komunës së Prishtinës, përkatësisht kundër Drejtorisë Komunale të Arsimit (në vijim: Drejtoria e Arsimit), lidhur me mosdhënien e përgjigjes në kërkesat e parashtruara.

Sipas pohimeve të ankueses, më 23 nëntor 2018 kryetari i Komunës së Prishtinës nxori Vendimin nr. 14-422/01-0280084/18, sipas të cilit:

"I. Miratohet Vendimi për subvencionimin e prindërve të cilët kanë të regjistruar fëmijët e tyre në çerdhet me bazë në komunitet, në komunën e Prishtinës.

II. Subvencionimi i prindërve sipas pikës I të këtij vendimi do të bëhet në bazë të të ardhurave mujore neto si në vijim:

- 1. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 500 €, subvencionohen 50 €;*
- 2. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 700€, subvencionohen 30 €;*
- 3. Prindërit me të ardhura mujore neto deri në 1000 €, subvencionohen 20 €.*

III. Prindërit të cilët kanë të regjistruar biznese funksionale diskualifikohen nga subvencionohet si në pikën II.

IV. Nëse prindërit nuk i raportojnë të dhënat e sakta mbi të hyrat, përjashtohen nga përfitimi i subvencionit në momentin e vërtetimit.

V. Vlerësimi i kërkesave dhe vendimmarja për subvencionim si në pikën II, do të bëhet nga një anëtar i caktuar nga komuna e Prishtinës dhe dy anëtare të caktuar nga çerdhja.

¹ "Avokati i Popullit ka kompetenca për t'i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit."

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>

VI. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria për Financa e komunës së Prishtinës.

VII. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi i dt. 9 shkurt 2016.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij.”

Sipas ankueses, ky vendim nuk u shfuqizua, ndryshuar apo pezulluar me ndonjë akt tjetër administrativ dhe, për rrjedhojë, vazhdon të prodhojë efekte juridike detyruese.

Meqë ky vendim nuk po zbatohet nga Komuna e Prishtinës, ankuesja pohoi se, në cilësinë e kryetares së Këshillit të Prindërve në kopshtin me bazë në komunitet [REDAKTUAR], fillimisht më 3 prill 2025, si dhe më 28 maj 2025 dhe 3 qershor 2025, nëpërmjet postës elektronike zyrtare, i parashtrroi kërkesë drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës, duke kërkuar zbatimin e vendimit të lartcekur, por nuk mori përgjigje zyrtare.

Më tej, ankuesja gjithashtu pohoi se më 18 qershor 2025, përsëri nëpërmjet postës elektronike, i parashtrroi ankesë drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, duke e vënë në dijeni edhe kryetarin e Komunës së Prishtinës lidhur me moszbatimin e vendimit. Si pasojë e moszbatimit, kopshti me bazë në komunitet [REDAKTUAR] po përballet me vështirësi serioze financiare, të cilat rrezikojnë funksionimin e rregullt të institucionit dhe realizimin e veprimtarisë edukativo-arsimore, çka nuk është në pajtim me interesin më të mirë të fëmijëve përfitues.

Pavarësisht këtyre parashtrësive, sipas ankueses, Komuna e Prishtinës dhe Drejtoria e Arsimit nuk ndërmorën veprime procedurale dhe nuk kthyen përgjigje zyrtare.

Në procedurën hetimore sipas ankesës, Avokati i Popullit iu drejtua kryetarit të Komunës së Prishtinës më 15 gusht 2025 dhe kërkoj informata lidhur me veprimet e ndërmarra ose të planifikuara në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore në këtë çështje. Meqenëse nuk mori përgjigje në shkresën e parë, Avokati i Popullit, më 7 tetor 2025, i dërgoi shkresë përsëritëse kryetarit të Komunës së Prishtinës, duke ia rikujtuar nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës³ dhe nenet 18 dhe 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, që u bëjnë thirrje autoriteteve publike t’u përgjigjen kërkesave të IAP-së për sigurimin e informacioneve, dokumenteve dhe dosjeve brenda kohës së arsyeshme. Avokati i Popullit, deri në publikimin e kësaj Letre me rekomandime, nuk mori përgjigje nga Komuna. Në këtë rast, Avokati i Popullit vlerëson se Komuna e Prishtinës dështoi të përgjigjej në kërkesën e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen në fjalë, gjë që përbën shkelje të dispozitave të Kushtetutës dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit. Sidoqoftë, kjo nuk e pengon Avokatin e Popullit që t’i japë konkluzionet dhe rekomandimet për këtë çështje.⁴

Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 28/04 qershor 2008⁵, përcakton organizimin dhe funksionimin e komunave si njësi themelore të qeverisjes. Ai rregullon kompetencat e komunave, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve publike, zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban dhe kujdesin për mirëqenien e qytetarëve. Gjithashtu, ligji garanton autonominë lokale, transparencën, pjesëmarrjen e

³ “Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’ia paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.”

⁴ Neni 24, paragrafi 4, i Ligjit për Avokatin e Popullit.

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

qytetarëve në vendimmarrje dhe bashkëpunimin ndërkomunal, duke siguruar që pushteti lokal të funksionojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Neni 11 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale përcakton:

“Kuvendi i komunës dhe kryetari kanë të drejtë të miratojnë akte dhe të ndëmarrin masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre. Të gjitha aktet komunale duhet të jenë në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës.”

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 20 / 21 qershor 2016, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: LPPA), ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike të personave. Gjithashtu, ky ligj rregullon dhe definon procedurën administrative, para së gjithash, si tërësi normash juridike me të cilat rregullohet mënyra e veprimit të organeve administrative shtetërore, organe këto të cilat, duke zbatuar normat e së drejtës materiale, nxjerrin akte administrative me të cilat vendosin për të drejtat, obligimet ose interesat e subjekteve përkatëse të së drejtës.

Neni 9 i LPPA-së shprehimisht përcakton:

“Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t’u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.”

Gjithashtu, neni 11 i LPPA-së, pos të tjerash, përcakton:

“Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.”

Sipas LPPA-së, përkatësisht nenit 97, procedura administrative e nisur sipas kërkesës përfundon me njoftimin e një akti administrativ. Në kuptim të nenit 98 të LPPA-së, procedura administrative duhet të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë sesa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. Pra, në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat të tillë, atëherë afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzet e pesë (45) ditë nga fillimi i saj, përveç rasteve të shtyrjes së afatit të përcaktuar në nenin 99 të LPPA-së. Në rast të shtyrjes së afatit fillestar, pala duhet të njoftohet për këtë, si dhe për datën e re të përfundimit të afatit. Rrjedhimisht, ky ligj në mënyrë të qartë parasheh obligimin e organit administrativ për të vepruar pas pranimit të kërkesave të palëve dhe për t’i njoftuar ato lidhur me vendimin e organit.

Po ashtu, neni 135 i LPPA-së përcakton edhe afatin për njoftimin për aktin që zgjidh ankesën, si në vijim:

“1. Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës. 2. Afati i paraparë nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shtyhet kur nevojiten shqyrtime administrative shtesë. Neni 99 i këtij Ligji do të zbatohet përshtatshmërisht gjithashtu për shtyrjen e afatit të paraparë sipas paragrafit 1 të këtij neni.”

LPPA-ja, në nenin 47, përcakton strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar. Organi publik, kur lëshon akte administrative të shkruara, duhet ta bëjë këtë në formën e përcaktuar nga LPPA-ja ose nga ligji i veçantë i fushës përkatëse të administratës. Në raste të tilla, akti administrativ i shkruar, nga aspekti i strukturës, duhet të përmbajë: pjesën hyrëse⁶, pjesën urdhëruese (dispozitivin)⁷, pjesën arsyetuese⁸ dhe pjesën përmbyllëse.⁹ Rrjedhimisht, Komuna, përkatësisht Drejtoria e Arsimit, nuk ofroi dëshmi me të cilat vërtetohet se ankuesi mori përgjigje.

Sipas LPPA-së, njoftimi i një dokumenti të shkruar kryhet nëpërmjet dërgimit me postë, në mënyrë elektronike apo nëpërmjet njoftimit formal. Pra, njoftimi duhet t'i bëhet personit të cilit i adresohet. Për më tepër, njoftimi formal bëhet nëpërmjet postës së certifikuar, dorëzimit personal, dorëzimit nëpërmjet të tretit, shpalljes publike, si dhe nëpërmjet shkarkimit elektronik apo publikimit zyrtar, siç parashihet në LPPA.

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës dështoi në përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, të parapara me nenin 11 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili i obligon komunat ta sigurojnë zbatimin efektiv të vendimeve dhe të akteve të nxjerra nga organet komunale. Moszbatimi i këtij vendimi përbën shkelje të parimeve të sundimit të ligjit, të administrimit të mirë dhe të barazisë në trajtimin e qytetarëve, duke cenuar të drejtat dhe interesat legjitime të përfituesve të synuar nga ky vendim.

Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës dështoi në përmbushjen e detyrimeve të saj ligjore, duke mos i kthyer ankueses përgjigje në kërkesat e saj të parashtruara më 3 prill 2025, më 28 maj 2025, më 3 qershor 2025, si dhe në ankesën e parashtruar më 18 qershor 2025, pavarësisht obligimit të qartë që rrjedh nga legjislacioni në fuqi për trajtimin dhe shqyrtimin brenda afateve të arsyeshme të çdo kërkesë apo ankese administrative. Mosveprimi i Komunës përbën shkelje të parimit të administrimit të mirë, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë institucionale, si dhe cenon të drejtën e ankueses për mjet juridik efektiv.

Për më tepër, Komuna e Prishtinës nuk e përmbushi detyrimin kushtetues të përcaktuar në nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 25 të Ligjit për Avokatin e Popullit, duke mos iu përgjigjur kërkesës zyrtare të Avokatit të Popullit për ofrimin e informatave dhe dokumentacionit lidhur me këtë rast. Ky mosbashkëpunim institucional paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të obligimit kushtetues për bashkëpunim me institucionin e pavarur kushtetues dhe cenon parimet e sundimit të ligjit dhe kontrollit demokratik mbi administratën publike.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”* Sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit duhet: *“Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla.”*

Prandaj, Avokati i Popullit i

⁶ LPPA, neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.

⁷ LPPA, neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

⁸ LPPA, neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3.

⁹ LPPA, neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4.

REKOMANDON

Komunës së Prishtinës:

- T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e plotë dhe efektiv të vendimit për subvencionimin e prindërve, të cilët fëmijët i kanë të regjistruar në kopshtin me bazë në komunitet [REDACTED].
- Kërkesat e [REDACTED] t'i trajtojë në pajtim me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.") dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

